



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA • REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

### Procesverbal i IX i Kuvendit të Komunës

I Mbajtur në takimin e IX-rë të rregullt të KK-së me datën 30.09.2025, në sallën e Kuvendit në ora 10:00 nën kryesimin e Kryesuesit të KK-së, Xhavit Zariqi, në prani të anëtarëve të saj, OJQ-ve dhe Zyrtares për informim.

#### Fjalën Hyrëse – Kryesuesi të KK-së, Xhavit Zariqi;

Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, drejtor/e, media dhe shoqëri civile, të nderuar dhe të respektuar Anëtarë të Kuvendit të Komunës së Ferizajt. Po fillojmë me mbledhjen e IX-rë të rregullt Kuvendit të Komunës së Ferizajt dhe për këtë mbledhje në bazë të materialit që e keni marr propozoj këtë rend dite:

#### Rendi i ditës:

1. Konfirmimi i pjesëmarrjes në mbledhjen e KK-së;
2. Miratimi i rendit të ditës;
3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar të KK-së;
4. Propozim – Vendim për Miratimin e Projekt Buxhetit të Komunës së Ferizajt për Vitin 2026
5. Propozim – Vendim për pezullimin e vendimit me nr: 01.Nr.41 të datës 30.04.2025
6. Pyetje dhe kërkesa dhe
7. Të ndryshme.

Kryesuesi theksoi që në kpf jemi marrë vesh që të fusim në rend të ditës edhe një pikë shtesë që është deklarata mbështetëse për eliminimin e dhumës ndaj grave në politikë dhe jetën publike, dhe pyeti nëse ka dikush rreth rendit të ditës dhe pasi spati u miratu rendi ditës me të gjitha votat për 00.

Sa i përket procesverbalit a ka dikush ndonjë qështje dhe pasi nuk pati edhe kjo pikë kaloi me të gjitha votat për 00.

Kryesuesi theksoi që kalojmë në pikën e 4 e që është miratimi i projektbuxhetit për vitin 2026 dhe ia kaloi fjalën kryetarit të komunës z.Agim Aliu.

I nderuar Kryesues i Kuvendit të Komunës,  
Drejtorë të drejtorive komunale,  
Të respektuar anëtarë të Kuvendit,  
Shoqëri civile, media,  
Zonja dhe zotërinj!

Në këtë ditë të fundit të shtatorit dhe po kështu në këtëseancë të fundit të kësaj legjislature, në agjendë punë kemi dokumentin themelor të qeverisjes lokale, kornizën investimore mbi të cilën vazhdoen esendërtohen projektet e së ardhmes për Ferizaj – Projekt Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2026.

Ky dokument me ndikim të drejtpërdrejt për të nesërmen dhe të ardhmen e Ferizajt e ferizajasve, buron nga vet qytetarët, me dëgjuesat publike që kemi organizuar, me qasjen gjithëpërfshirëse, me kontaktin e takimet e drejtpërdrejta, me vlerësimin e çdo ideje a propozimi por edhe analizës sonë të vazhdueshmesektoriale mbi investimet publike, me qëllimin parësor vendimtar: të zbatojmë nisma e projekte që meriton Ferizaj i ynë.

Duke qenë një pasqyrë ku reflektohen kërkesat qytetare, vizioni ynë për transformimin e gjithmbarshëm e të shumanshëm të Ferizajt, pesha e veçantë që bart ky volum punësh i organizuar e kornizuar brenda buxhetit për vitin 2026 dhe projekcionit të hershëm për vitet pasrëndëse, bënë që çdo lloj agje, çdo vendbanim, secili ferizajas, si ngafshatrat ashtu edhe qyteti, ta ketë zërin e tij në këtëprojeksion investimor për të ardhmen e Ferizajt.

Në lartësinë e përgjegjësisë dhe përgjegjshmërisë përbesimin e jashtëzakonshëm që morëm nga qytetarët, për ta ngritur e fuqizuar çdo ditë Ferizajn tonë, ideuamdhjetëra projekte, nisma e ide që përkthehen me punëtonë, në mundësi të shtuara, vazhdim të transformimit, modernizim, mirëqenie e shërbim cilësor për Ferizajn e qytetarët e tij.

Në çdo fjalë e fjali të këtij Buxheti, në çdo faqe tëkalkuluar me shifra - idetë e projektet që çojnë përparaFerizajn, reflektohet vizioni ynë, energjia qëmanifeston përgjigjen në pritshmëritë e ferizajasve, përta bërë me guxim, me cilësitë e dëshmuaraprofesionale, me ndershmëri – Ferizajn për brezat e sotëm e të ardhshëm.

Edhe sot, nga kjo foltore e zërit të qytetarëve, i themiferizajasve PO: Vazhdojmë me punë e projekte, nismae ide, angazhim e energji që nuk shteron, për ta bërëFerizajn ashtu siç e meriton, ashtu siç e duan qytetarët, ashtu siç na dhatë besimin për ta bërë më të mirën, më të duhurën, për ta lartësuar krenarë akoma më shumë, emrin e qytetit tonë.

Zonja dhe zotërinj!

Janë pafund projekte të rëndësisë kapitale, të cilatparaqiten detajisht e të përlogaritura në këtëpr ojeksion buxhetor, shtrirë në kohë zbatimi e me buxhetet që kërkojnë, garanci kjo për pandalshmërinë e punëve në Ferizaj, pandalshmërinë e shërbimit përferizajasit.

Buxheti i Komunës së Ferizajt për vitin 2026, arrinlartësinë në vlerën totale 54,068,494.00€ e që ndarëvetëm në fushën e investimeve kapitale kemi14,413,714.00€ për projektet kapitale të Komunës sëFerizajt për vitin kalendarik 2026.

Me këtë dokument, vendosen në kalendarin e punëvepublike, projekte të reja, nisma me dobi të drejtpërdrejt për qytetarët, andaj si i tillë, është vendimmarrje e drejtpërdrejt për nevojat investimor e të ferizajasve, gërshetuar me vizionin tonë për t'i dhënë akoma më shumë, vepra madhore e ide ntitare Ferizajt, zhvillim e transformim që reflektohet në mirëqenie e shërbim për qytetarët.

Projektet e gjelbërta ishin fokusi i këtij mandatiqeverisës, mandatit të gjelbër të Ferizajt, ku siasn jëherë më parë në historinë e qeverisjeve në Ferizaj, me guxim, me profesionalizëm, me vizion të dëshmuarse ku duam ta shohim Ferizajn në të ardhmen, hapëmfronte të shumta pun e, duke i dhënë kuptim tjetërorganizimit të hapësirave publike, me parqe masive qëpo jetësohen çd o ditë, me miniparqet si koncept qëinstaluar - për të gjelbërtën në hapësira urbane e rurale.

Me zgjerimin e Parkut të Lirisë dhe Parkun në Kodrëne Sherretëve së cilës do t'i shtojmë edhe një rrugë përfaqje më të shpejt e më lehtë nga qytetarët, po jetësojmë këto megaprojekte të gjelbërta, pa lënë anash edhe punimet në Parkun tek ish lokacioni i Kompanisë "Pastërtia", Parkun tek Stationi i Vjetër i Autobusëve dhe miniparqet në zonë urbane e rurale ku në këtëmandat qeverisës investuam afro 6 milionë euro në tëgjelbërtën, projekte këto me jetësimin e së cilave, ferizajasit fitojnë qindra hektarë hapësira të reja tëgjelbërta në zemër të qytetit.

Me këtë vizion pune që do të vazhdoj për Ferizajn e Gjelbër, kemi projektuar dhe do t'i shtojmë kurorës sëgjelbër të Ferizajt edhe Parkun e Ri të Qytetit me hapësirë prej 1.4 hektarë si dhe ndërtimin e Bulevardit të Rinisë – masive e korridore të gjelbërta që i japinidentitet të ri urban qytetit tonë.

Sa i përket infrastrukturës rrugore, duke qenë kampion të projekteve madhore e transformuese të qytetit me ndikim direkt zhvillimin e tij - referencë e model për qytetet tjera, do të vazhdojmë me projektin e ri përndërtimin e Unazës së Brendshme të Qytetit, një front iri pune infrastrukturore që transformon gjithë trupin e Ferizajt, në rrugë më të gjera, me infrastrukturë moderne, lehtësi më të madhe qarkullimi e trafik tëorganizuar.

Pa lënë anash edhe projeksionet tona për ndërtimin e infrastrukturës rrugore që lidh e komunikon zonaturbane e fshatrat me njëra-tjetrën si asfaltimi i rrugës që lidh rrugën "Naim Beka" me rrugën "Epopeja e Jezercit", rruga Manastirc-Pleshinë, rruga Prelez i Jerlive-Prelez i Muhaxherëve, rrugët e lagjes Sherret, trotuare e zgjerim rrugësh në fshatra e në qytet.

Në këtë pikëpamje, në projeksionin buxhetor për vitin 2026 zënë vend edhe një numër i madh projektesh të reja të natyrës së infrastrukturës nëntokësore, siinvestimi në rrjetet e ujësjellësit dhe kanalizimit, kolektor të ujërave të zeza shtrirë këto projekte në fshatrat si: Greme, Zaskok, Pojatë, Du bravë, Nikadin, Fshat i Vjetër, Gaçkë, Prelez e Muhoc si dhe në zona tjera rurale e urbane.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në fushën e shëndetësisë, përtej investimeve milionëshe në ngrehina të reja e infrastrukturë moderne shëndetësore anekënd Ferizajt,  
me qasjen që t'i sjellim pranë qytetarëve shërbimet shëndetësore, përmes ndërtimit të objektit të ri të Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendrës së Mjekësisë Familjare nr.2 – një objekt modern,  
me të gjitha pajisjet – igatshëm për punë, Qendrat e Mjekësisë Familjare në Neredime, Dardani, Softaj, Prelez të Muhaxherëve dhe në Koshare.....

..... Do të vazhdojmë me projekte që i japin cilësi, dimension e shtrirje të re shërbimeve shëndetësore në gjithë territorin e Ferizajt si ndërtimi i një Qendre të Mjekësisë Familjare të re në qytet, ndërtimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare nr.12, rikonstruktimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare nr.1 në Qendër Emergjente dhe Specialistike e deri tek avancimi i shërbimeve si kujdesi paliativ për të cilat tashmë janë zhvilluar të gjitha vlerësimet e analizattona profesionale e janë pjesë e kalendarit të punëve në këtë projekt buxhet.

Në këtë sferë, një komponente me peshë të veçantë në kuadër të punës sonë ka qenë e mbetet edhe mirëqenia sociale,  
me angazhimet tona të drejtpërdrejta, bashkëpunimet e frytshme, investimet e punët publike që rrisin kapacitetet në kuadër të infrastrukturës së kujdesit social.

Në planin e arsimit, përveç 7 objekteve të reja shkollore që ndërtuam dhe 4 në proces të avancuar të punimeve,  
do të implementojmë për herë të parë në vend, projektin e veçantë të kampuseve shkollore, duke i kthyer këto zona në ambiente të reja me infrastrukturë moderne në shërbim të shkollave dhe komunitetit.

Në këtë mes, fokus të veçantë në planin e arsimit,  
do të ketë digjitalizimi, ku kemi ideuar e tashmë edhe planifikuar financiarisht në këtë projekt buxhet, pajisje të gjitha dhomave të mësimi me tabela digjitale (smart board) si dhe ndërlidhjen e bibliotekave të shkollave me bibliotekën e qytetit, që nxënësit të kenë qasje të lehtë në literaturë përmes pajisjeve teknologjike.

Një projekt unik në gjithë vendin, që është vazhdimësie vizionit tonë për sportin shkollor, është ndërtimi i kompleksit për sportin shkollor në hapësirat e ish- Stadiumit të Qytetit “Ismet Shabani” – një zonë që do t’i shërbej jo vetëm arsimit ferizajas për të fuqizuar sportin shkollor por edhe vetë komunitetit sportiv.

Po kështu, në kuadër të infrastrukturës shkollore kemitashmë të planifikuar dhe buxhetuar, ndërtimin e objekteve të reja të shkollave si në Manastirc, Varosh, ndërtimi i çerdhes së re në qytet, hapja e çerdheve në rajonet si në Grykën e Neredimes, Pleshinë, Talinoc i Muhaxherëve, rikonstruktimi i objekteve shkollore në çerdhe si në Lloshkobare e Komogllavë, si dhe infrastruktura sportive shkollore si ndërtimi i sallave sportive në shkollat “Vezir Jashari”, “Riza Matoshi” dhe “Afrim Abazi”.

Në sferën e kulturës, rinisë dhe sportit, përtejkryeprojekteve si Stadiumi i Ri i Qytetit “Ismet Shabani” dhe Pallati i Kulturës - hisedarë të së cilave investime është Komuna e Ferizajt, kemi në ëprojeksionin tonë buxhetor, ndërtimin e një Palestre të Re Sportive në qytet me kapacitet të madh e qendër sportive për ndeshje sportive kombëtare e ndërkombe si dhe renovimin e brendshëm të Palestrës ekzistuese të Sportit “Bill Clinton”.....

.....

.....po kështu ndërtimin e stadiumit ndihmës të futbollit në Sazli, rikonstruktimin e Qendrës Rinore dhe Kinemasë së Qytetit, për të vazhduar me projektin unik në Parkun Memorial të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në Jezerc, përmes ndërtimit të pikave luftarake si dhe rikonstruktimit të Memorialit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës – investime këto me peshë për historinë, lavdinë, kujtesën tonë për lirinë.

Do të vazhdojmë gjithashtu me përkushtim zgjerimin e rritjen cilësore të mirëmbajtjes së hapësirave publike, sipjesë e investimeve në planin e shërbimeve publike sidhe fuqizimin e digjitalizimit në shërbimeve në kuadër të Trafikut Urban si dhe zgjidhjet infrastrukturore përnyjet e trafikut rrugor.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Në planin e investimeve për bujqësinë, zhvillimin ekonomik dhe turizmin, kemi planifikuar një vlerë të shterprojektesh. Përveç mbështetjes si asnjëherë më parë, me mbi 10 milionë euro subvencione për bujqit e fermerët përgjatë këtyre viteve, po kështu edhe

mbështetjen për gratë në biznes ku të gjithë Fondin Komunal për Mbështetje të Bizneseve ia dedi kuamndër vite grave në biznes.....

.....do të zhvillojmë projektin që i jep dimension të ri zhvillimit ekonomik të Ferizajt, përmes ndërtimit të infrastrukturës në zonat ekonomike në Babush, Mirash dhe Gurëz – gjeneratorë këta të njërimiti të ri zhvillimi për ekonominë e Ferizajt.

Një projekt i veçantë në fushën e bujqësisë, përveç investimeve që po vazhdojnë në sillose, hipodromin e të tjera projekte që tashmë kanë përfunduar si ato të pak ditëve më parë që përuruar - Tregu i Kafshëve dhe Strehimorja për Qentë Endacak, në këtë projektion buxhetor kemi paraparë edhe ndërtimin e Tregut të Kafshëve në fshatin Dardani.

Po kështu, në pikëpamje të turizmit, përveç infrastrukturës ligjore që tashmë kemi përgatitur e mbrojtjes dhe promovimit të aseteve tona turistike, do t'i japim hov të reja zhvillimi zonës së Neredimes dhe Jezercit, përmes investimeve në krijimin e infrastrukturës së nevojshme që rrit përdorimin e këtyre hapësirave nga vendasit dhe tërheq turistin në këto zona.

Edhe në fushën e administratës, pronës, kadastrit e gjeodezisë, do të vijojnë përpjekjet, investimet e nismatona, për të modernizuar e digjitalizuar shërbimet, ashtu që të rritet cilësia, shpejtësia dhe qasja e qytetarëve në shërbimet komunale e në veçanti është projektin ynë për ndërtimin e objektit të ri të Komunësme parking nëntokësor – vizioni ynë që synojmë ta realizojmë si bashkëfinancim me Qeverinë.

Të nderuar anëtarë të Kuvendit!

Ky projekt buxhet është zëri i kërkesave të qytetarëve, është vizioni që ka shoqëruar transformimin e Ferizajtpërgjatë këtyre viteve, është dëshmia se puna flet mëzëshëm sesa gjithçka tjetër, andaj dua që përmes kësajparaqitje në këtë séancë të fundit të kësaj legjislature, ku kemi para vetes planifikimin buxhetor për vitin 2026 me projektet e rëndësisë kapitale, t'ju falënderoj për mbështetjen e nismave e projekteve përgjatë viteve të cilën jam besimplotë se do

ta bëni edhe sot përmeskëtij projektbuxheti, implementimi i së cilave e bëri Ferizajn të transformo  
het, e bëri Ferizajn më të mirë e modern,  
e bëri Ferizajn ashtu siç e meriton, për të vazhduar pa ndalshëm, çdo ditë, në misionin tonë për Fer  
izajn e ferizajasit, për krenarinë tonë – Ferizajntonë.

Ju faleminderit!

Kryesuesi theksoi që e hap debatin për buxhetin fjalën e morri Verona Isaku e cila pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kryetar mirë se ke ardhë në seancën e fundit tanen se di pse u dasht me ardhë ke mujt me lshu ndonjë prjektor I ki premtimet e njejta, rregullimi i tregut dhe strehimoreve jeni ba bajat, ti gjith i ndan paret kurr se kryen, te parku liria e ke parapa me rrit, shpresoj të del pak ma mirë e mos tdel ndonjë bisede në ëatssap, qerdhet a e di që i ki 3 qerdhe që si ke aktivizu hala e jeni mundu me ba pazare.

E ke parapa rikonstruktimin me tabela digjitale kjo është hajgare, ata skan ujë me lag shpuzën e ti ju fol smartëordat po ju e keni degradu arsimin. Ju falemnderit.

Brahim Osmani pasi përshëndeti të pranishmit theksoi se po e filloj diskutimin a me fillu me programin e drejtoris së financave a kta tanin po jam i pregadit për të dya për një arsye se janë përsëritës, ti thu projektet e detajume po aty shkrun 1.1 milion kubza gjana që se di kush ku kan me shku, manej në softaj e ke shkru me 30 mi euro, po ti përmendi 3.4 miliion e që ti se di sakt ku kan me shku ato.

Pse janë përsëritëse po dal edhe të projektet tjera, a ste mjaftun 10 vjet në secilin buxhet i ke nda ka 50 mij euro dhe ske arrit me rregullu atë pjesë. Në greme dhe dremjak unë i bana 4 vjet e ti i ki 10 vjet kryetar edhe si ke rregullu. Asfaltimi i rrugve softaj edhe kta prej që jam në kuvend e përsërisni, ti thu e kom rregullu tregun e knej në buxhet e shtin prap që 100 mij euro ose ju ke met borgj ose se ke përfundu.

Knej po thu e ke ba gjelbërimin e knej e ke hjek projektin e pishave në rahovicë ske pas projekt hiq po je dal ju ke than i ke mashtru anej qytetart.

Që 10 vjet janë projektet e njëjta e që kurr su kryen.

Besim Haziri pasi përshëndeti të pranishmit theksoi që kur e ndëgjon kryetarin tu fol për një moment harron që jeton në Ferizaj mirpo tdoket që jeton në ndonjë zvicërr apo gjermani, unë e kom ni tu than Ferizaj shembull është e vërtert kryetar mirpo me marr shembull për të keq, transofrmimi sigurisht që po mirpo për te keq te infrastruktura është jo e qasshme mbi 60% jo funksionale për persona me nevoja të veqnata.

Kto probleme e kto gabime një qytet european nuk i ka po i ka veq Ferizaj, hapsira të gjermberta pot sfidoj kryetar që ka dikun hapsir të gjelbert nuk ka nja u kan mbrapa postës mirpo edhe aj nuk është.

Ferizaj i gjeneratës tjetër me të vërtet i gjeneratës tjetër pasi ajo gjenerat ka shumë punë me rindërtu pasi e ke ndërtu krejt gabim. Ma shumë ka qenë se njerz në qytet mbeturinat ma ka 2 javë si keni marrë.

Flmaur Istrefi pasi përshëndeti theksoi që ky buxhet do të duhej të paraqiste vizionin e kryetarit dhe jo të diskutohet në vitn 2025 për ujë kanalizim dhe kjo është dëshmi e kjart për dështime, këtu ka projekte të përsëritura psh rregullimi i tregut të gjelbert ky projekt su ba kurr dhe auv e ka

mbyllë pjesën e bylmetit për shkak që ska kushte as minimale për ta kryer aktivitetin aty. Shtëpia e pensionistëve u bën 5 vite dhe as su nis kurr, shkolla në varosh e përsëritur. Rregullimi i tregut dhe strehimorja ndërsa kryetari tha e kem inaguru e në buxhet u ribuxhetu. Pytja është qysh met besu kryetar për projekte të përsritura.

Kryetari ska pas as guxim as besim po e ka zgjedh heshtjen ka heshtur kur ka ndodhë devime pronave në zaskok ka heshtu kur zyrtart janë kan me aktakuza ka heshtu kur u gjet arsenal armesh në shkolla ka hesht kur është gravu nëpër nënkalime, kryesuesi e ndërpreu duke i thënë që jemi tu fol për projektbuxhetin e jo për kso gjana.

Kryesuesi Xhavit Zariqi pasi theksoi që është një debat shumë i dobët sa i përket diskutimeve pasi po bëhen politike dhe jo konstruktive për ta diskutuar buxhetin ashtu si duhet apo si do të duhej, në legjislaturat e tjera kishte ndryshime të buxhetit pasi kjo bëhet ligj dhe duhet të propozohen projekte dhe jo debat i tillë politikë ndonse është vit i fundit është vit zgjedhor mirpo sdo të ishte korrekte kjo diskutim.

Më pas e ndaloi debatin dhe e hodhi në votim këtë pikë dhe kaloi me 24 vota për, me 8 kundër dhe 0 abstenim e kaloi pikën e buxhetit.

Kryetari dhe Kryesuesi Xhavit Zariqi u uruan qytetarëve këtë buxhet.

Kryesuesi e lexoi pikën e 5 dhe pasi spati të interesuar për debat e hodhi në votim dhe kaloi me 24 vota për 00.

Pikën e 6 atë që e theksova më herët si shtesë në kpf e ftoj ta lexoj Mimoza Pajazitin pasi që të njëjtën e keni marrë edhe me email edhe me letër.

Tek pyetje dhe kërkesa nuk pati për të diskutuar andaj Kryesuesi ju uroj suksese në zgjedhje subjekteve politike dhe kandidatëve për asambable ndërsa këtë mbledhje të fundit për këtë legjislaturë e shpalli të mbyllur.

Procesmbajtës:

Leutrim Mahmuti

Kryesuesi i Kuvendit të Komunës

Xhavit Zariqi

